

Urdhër nr. 381, datë 23.6.2020 “Për miratimin e protokollit për funksionimin e qendrave publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas periudhës së fatkeqësisë natyrore, deri në përfundim të masave të distancimit fizik/social, për shkak të epidemisë covid-19”

Ky urdhër ka dalë në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; të pikës 6.1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, MSHMS, miraton “Protokollin për funksionimin e qendrave publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, gjatë dhe pas periudhës së fatkeqësisë natyrore, deri në përfundim të masave të distancimit fizik/social, për shkak të epidemisë COVID-19”. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror, qendrat publike dhe jopublike, jorezidenciale, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, si dhe bashkitë. Ky udhëzim ka si qëllim të mbrojë dhe të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara, të përfshihen në qasjen e re digjitale që ofrohet për të gjithë fëmijët në kushtet e fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë COVID-19.

Më konkretisht, ky udhëzim synon:

- të sigurojë vazhdimin e mbështetjes për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara në kuadrin e zbatimit të “Standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat rezidenciale dhe ditore, të miratuara me vendim nr. 822, datë 6.12.2006” (më poshtë të quajtura “Standarde të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara”) dhe në përputhje me Manualin e Zbatimit të Standardeve të Shërbimeve për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe në kushtet e fatkeqësisë natyrore”;

- të sigurojë ofrimin e mbështetjes psikosociale për prindërit e fëmijëve/të rinjve në përgjithësi dhe në veçanti, në kushtet e stresit të shtuar, për shkak të COVID-19 dhe masave shtrënguese shoqërore;

- të aftësojë ofruesit e shërbimeve në përdorimin e mekanizmave të shërbimit *online*, shoqëruar me rregulla dhe kritere të qarta, për shërbimin e ofruar në këtë mënyrë;

- të rrisë përmes trajnimeve aftësinë e ofruesve të shërbimeve, për të ofruar mbështetje psikosociale për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve/të rinjve me aftësi të kufizuara, për përballimin e stresit të shtuar;

- të ndërtojë një platformë pune, në përputhje me kërkesat e distancimit social/fizik, kur mbështetja *online* nuk është e mundur ose përfundon;

- të sigurojë respektimin e parimeve dhe të kërkesave, të:

- Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;

- udhëzimet specifike të vazhdueshme të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik dhe OBSH-së për COVID-19;

- konsiderime për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara – përgjigje e UNICEF-it ndaj COVID-19 (COVID-19 response – UNICEF);

- mbështetje për fëmijët dhe për familjet përgjatë COVID-19 – Autizmi flet (*Autism speaks*);

- të mësuarit në distancim social – UNESCO;

- personat me aftësi të kufizuara dhe COVID-19 – QKS (CDC).

Objekt i udhëzimit janë shërbimet e ofruara nga të gjitha qendrat publike dhe jopublike komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara, për fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore dhe deri në përfundim të masave të marra për epideminë COVID-19, ku kërkohet distancim social/fizik. Ky udhëzim vendos rregulla, për:

- bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës së qendrave komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/të specializuara, në territorin e tyre;

- qendrat komunitare/ditore/gjysmëditore/të zhvillimit/ të specializuara për personat me aftësi të kufizuara dhe për personelin profesionist të tyre, për punën me personat me aftësi të kufizuara, mbështetjen psikosociale të prindërve e kujdestarëve të fëmijëve dhe bashkëpunimin me ta.

Lexoni të plotë në: <https://juristionline.al/wp-content/uploads/2020/12/urdher-2020-06-23-381.pdf>;